



REPUBLIKA E SHQIPERISË  
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË  
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 139 Prot.

Vlorë, më 28.01.2017

**VENDIM**  
**Nr. 4, datë 28.01.2017**

**PËR KRITERET E PROCEDURËS SË PËRZGJEDHJES SË  
ADMINISTRATORIT TË UNIVERSITETIT "ISMAIL QEMALI", VLORË.**

Në bazë të nenit 49, pika 1, shkronja "f", të ligjit nr. 80/2015, datë 22.07.2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në RSH", Bordi i Administrimit është përgjegjës për caktimin e kriterëve dhe të procedurave për punësimin e administratorëve dhe personelit administrativ.

Nisur nga sa më sipër, Bordi i Administrimit:

**VENDOSI:**

1. Të miratojë kriteret si më poshtë:

Administratori i Universitetit duhet:

1. Të jetë shtetas shqiptar;
2. Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
3. Të jetë i aftë nga ana shëndetësore;
4. Të ketë arsim të lartë, së paku në nivelin "Master i Shkencave", në fushën e drejtësisë ose të ekonomisë dhe përvojë pune së paku 7 (shtatë) vjet në këto fusha;
5. Të ketë notë mesatare të paktën 8.5, të të dy cikleve të studimit së bashku;
6. Të njohë të paktën 1 (një) gjuhë të huaj (anglisht), në nivelin B2;
7. Të ketë përvojë pune në Institucione të Arsimit të Lartë, në fushën e administrimit financiar apo mësimdhënies në fushën ekonomike;
8. Të ketë përvojë pune në buxhetimin dhe menaxhimin e fondeve të BE-së;
9. Të mos jetë dënuar me vendim gjykatë të formës së prerë për kryerjen e një krimi;



REPUBLIKA E SHQIPERISË  
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË  
BORDI I ADMINISTRIMIT

10. Të mos jetë marrë ndaj tij masa disiplinore e largimit nga administrata shtetërore, që nuk është shuar sipas ligjit;
11. Të ketë vlerësime pozitive të përvojave të mëparshme të punës;
12. Të ketë trajnime/kualifikime brenda ose jashtë vendit, të lidhura me funksionet e administratorit;
13. Të ketë aftësi komunikimi, bashkëpunimi dhe menaxhimi për të zgjidhur çështjet me eficiencë.

Dokumentet që duhet të shoqërojnë kërkesën:

1. Fotokopje të letërnjoftimit;
2. Një kopje jetëshkrimi;
3. Kopje e noterizuar e diplomës/diplomave dhe/ose njehsimin e tyre në MAS (për diplomat e marra jashtë vendit), bashkë me listë notash të noterizuara (të dy cikleve të studimit);
4. Kopje e librezës së punës;
5. Vërtetim i gjendjes gjyqësore, vetë deklarim sipas formës së kërkuar nga ligji;
6. Vërtetim i gjendjes shëndetësore;
7. Vërtetim nga punëdhënës të mëparshëm, që nuk ka masë disiplinore në fuqi;
8. Certifikata të kualifikimeve dhe trajnimeve;
9. Dëshmi të njohjes së gjuhës së huaj, sipas testeve ndërkombëtare;
10. Referenca nga punëdhënës të mëparshëm, që provojnë vlerësimet pozitive në punë.

**2. Të interesuarit duhet të dërgojnë me postë dokumentacionin përkatës, në adresën:**

Universiteti "Ismail Qemali"  
Rektorati  
Sheshi "Pavarësia" Skelë-Vlorë

**3. Nuk lejohet paraqitja e dokumentacionit dorazi.**

4. Afati i dorëzimit të dosjeve është periudha 1 shkurt 2017- 14 shkurt 2017. Ngarkohet Rektorati (**Spektori i Administrimit të Burimeve Njerëzore dhe Dokumentit zyrtar**) të bëjë shpalljen për konkurim të hapur për pozicionin e Administratorit, në ueb site-in e Universitetit "Ismail Qemali" të Vlorës, MAS dhe APP .
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.



REPUBLIKA E SHQIPERISË  
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE  
BORDI I ADMINISTRIMIT

6. Vendimi regjistrohet dhe arkivohet.

**KRYETARI**

Znj. Rezana VRAPI

1. Znj. Ornela Koleka – anëtar
2. Z. Florian Nurçe – anëtar
3. Znj. Enida Pulaj – anëtar
4. Z. Eduard Ahmeti – anëtar
5. Znj. Marinela Muço – anëtar
6. Z. Elsajed Rexhaj – anëtar

Ky dokument përpilohet në 3 (tri) kopje.